



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 65

Tiranë – E mërkurë, 29 prill 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 17, datë 16.4.2015	Për llojin, përmbajtjen, formatin dhe procedurën e dhënies së dokumenteve të certifikimit për kursantët në sistemin e formimit profesional..... 2873
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 135, datë 16.4.2015	Për miratimin e mënyrës së administrimit të formatit të Regjistrit të Transfertave Individuale dhe të Regjistrit Kombëtar të Transfertave, si dhe mënyrën e administrimit të tyre..... 2874
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 157, datë 21.4.2015	Për licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të Drejtën e Artistëve Interpretë dhe/ose Ekzekutues të veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik, "AKDIE"..... 2876
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 158, datë 21.4.2015	Për licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të Drejtat e Autorit "Albautor"..... 2876
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 7, datë 26.2.2015	Për licencimin sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Mirditë..... 2876
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 8, datë 16.3.2015	Për fillimin e procedurave hetimore administrative..... 2877
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 9, datë 16.3.2015	Për mosshqyrtim të propozimeve për ndryshim tarife..... 2877
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 10, datë 16.3.2015	Për licencimin sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kavajë..... 2877

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 11, datë 31.3.2015	Për licencimin sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë.....	2878
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 12, datë 31.3.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 11, datë 21.2.2013 "Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës Elbasan Fshat".....	2878
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 13, datë 31.3.2015	Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë "U Polican" sh.a.....	2878
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 14, datë 31.3.2015	Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë "UK Ersekë" sh.a.....	2879
Kërkesë e ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 1003/10, datë 20.4.2015	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit "tokë bujqësore arë", që preken nga ndërtimi i linjës 110 KV, Lapaj-Peshkopi".....	2879
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2425, datë 21.4.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan (shitesa).....	2881
	Shtojcat e munguara të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 299, datë 8.4.2015, "Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 61, datë 22 prill 2015, faqe 2659.....	2882

**UDHËZIM****Nr. 17, datë 16.4.2015****PËR LLOJIN, PËRMBAJTJEN,
FORMATIN DHE PROCEDURËN E
DHËNIES SË DOKUMENTEVE TË
CERTIFIKIMIT PËR KURSANTËT NË
SISTEMIN E FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 14 pika 2 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Dokumentet e certifikimit janë dokumentet zyrtare që pasqyrojnë rezultatet e arritjeve të kursantëve për programe të kurseve kombëtare ose të veçanta të formimit profesional.

2. Dokumentet e certifikimit që lëshohen nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional për kursantët që ndjekin kurset e formimit profesional janë:

- a) Certifikata kombëtare;
- b) Certifikata;
- c) Dëshmia.

3. "Certifikata kombëtare" lëshohet për kursin e unifikuar të formimit profesional kur kursanti përfundon me sukses programin përkatës.

4. "Certifikata" lëshohet për kursin jo të unifikuar të formimit profesional kur kursanti përfundon me sukses programin përkatës.

5. "Dëshmia" lëshohet për kursantët që kanë ndjekur kursin e formimit profesional, por nuk kanë plotësuar kushtet për t'u pajisur me certifikatë.

6. Konsiderohen që nuk plotësojnë kushtet për certifikim:

a) Kur kursantët nuk përmbushin plotësisht programin e një kursi kombëtar ose të veçantë;

b) Nuk përmbushin rregullat për të hyrë apo janë vlerësuar negativisht në provimin përfundimtar (nëse aplikohet).

7. Certifikata kombëtare përmban këto elemente:

a) Stëmën e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale;

b) Emrin dhe kodin identifikues të institucionit ofrues të kursit kombëtar të formimit, që lëshon certifikatën;

c) Të dhënat personale të kursantit që përfton certifikatën, përfshirë: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, si dhe kodin identifikues;

ç) Të dhënat për kursin kombëtar (emërtimi, kohëzgjatja, kod);

d) Rezultatet e provimit përfundimtar;

dh) Datën e lëshimit të certifikatës;

e) Emrin dhe pozicionin e personit nënshkrues të autorizuar prej institucionit përkatës të formimit profesional;

ë)Vulën e institucionit.

8. Certifikata përmban këto elemente:

a) Emrin dhe kodin identifikues të institucionit ofrues të formimit profesional që lëshon certifikatën;

b) Të dhënat personale të kursantit që përfton certifikatën, përfshirë: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, si dhe kodin identifikues;

c) Të dhënat për kursin e formimit (emërtimi, kohëzgjatja);

ç) Rezultatet e kursit në bazë të njësive mësimore (module, lëndë, tema, projekte etj.);

d) Rezultatet e provimit përfundimtar (nëse aplikohet);

dh) Datën e lëshimit të certifikatës;

e) Emrin dhe pozicionin e personit nënshkrues të autorizuar prej institucionit përkatës të formimit profesional;

ë)Vulën e institucionit.

9. Dëshmitë përmbajnë këto elemente:

a) Emrin dhe kodin identifikues të institucionit ofrues të formimit profesional që lëshon dëshminë;

b) Të dhënat personale të kursantit që përfton dëshminë, përfshirë: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, si dhe kodin identifikues;

c) Listën e njësive mësimore (module, lëndë, tema, projekte, etj.) ku është kalues kursanti dhe rezultatet përkatëse të vlerësimit;

ç) Datën e lëshimit të dëshmisë;

d) Emrin dhe pozicionin e personit nënshkrues i autorizuar prej institucionit përkatës të formimit profesional;

dh)Vulën e institucionit.

10. Format i certifikatës kombëtare përgatitet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional e Kualifikimeve dhe miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

11. Format i certifikatës përgatitet dhe miratohet nga vetë institucioni ofrues i kursit të veçantë.



12. Institucionet publike ofruese të formimit profesional dhe institucionet jopublike të licencuara të formimit profesional marrin masa për shpërndarjen e dokumenteve të certifikimit.

13. Dokumenti i certifikimit i jepet vetëm personit në emër të të cilit është lëshuar, apo një personi tjetër të autorizuar me prokurë prej tij.

14. Kopjet e certifikatave dhe dëshmime me fotografi të çdo kursanti arkivohen.

15. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe institucionet ofruese të formimit profesional.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

URDHËR

Nr. 135, datë 16.4.2015

**PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË
ADMINISTRIMIT TË FORMATIT TË
REGJISTRIT TË TRANSFERTAVE
INDIVIDUALE DHE TË REGJISTRIT
KOMBËTAR TË TRANSFERTAVE, SI
DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË
TYRE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës "d" të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të pikës 19 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.6.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre",

URDHËROJ:

1. Regjistri i transfertave individuale të mbetjeve të rrezikshme mbahet nga dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve të rrezikshme në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, sipas formatit në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Regjistri i transfertave individuale plotësohet për çdo dokument dorëzimi dhe ruhet për një afat 3-vjeçar. Dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve të rrezikshme dërgojnë kopje të regjistrit të transfertave individuale pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dy herë në vit, nga data 1 deri 15 maj dhe nga data 1 deri 15 nëntor.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon Regjistrin Kombëtar të Transfertave të mbetjeve të rrezikshme sipas formatit në shtojcën 2 bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Regjistri Kombëtar i Transfertave të mbetjeve të rrezikshme përditësohet dy herë në vit brenda datës 15 qershor dhe 15 dhjetor.

5. Personi/at përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Transfertave të mbetjeve të rrezikshme caktohen me urdhër të titullarit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit dërgon pranë Ministrisë kopje të Regjistrit Kombëtar të Transfertave të mbetjeve të rrezikshme brenda 10 ditëve pune nga përditësimi i tij.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka



SHTOJCA 1

FORMATI I RREGJISTRIT TË TRANSFERTAVE INDIVIDUAL TË MBETJEVE TË RREZIKSHME

Kodi Unik	Numri i Regjistrimit (NIPT)	Nr. Indetifikimit të Lejes së Mjedisit të Tipit III.1	Nr. Indetifikimit të Liçencës të Tipit III.2 B	Lloji i mbetjes/kodi i mbetjes sipas Katalogut shqiptar të mbetjeve	Nr. i certifikatës së miratimit të mjetit sipas ADR. Data e miratimit dhe e mbarimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës.	Forma fizike (e gaztë, e lëngët, e ngurtë, pluhur, llum, apo e përzier	Numri i regjistrimit të automjetit (Targa)	Data dhe ora e kryerjes së transfertës	Emri/mbiemri i dorëzuesi/marrësit Adresa Nr. Telefoni E - mail

SHTOJCA 2

FORMATI I RREGJISTRIT KOMBËTAR TË TRANSFERTAVE PËR MBETJET E RREZIKSHME

NR.	Kodi Unik	Numri i Regjistrimit (NIPT)	Nr. Indetifikimit të Lejes së Mjedisit të Tipit III.1	Nr. Indetifikimit të Liçencës të Tipit III.2 B	Lloji i mbetjes/kodi i mbetjes sipas Katalogut shqiptar të mbetjeve	Nr. i certifikatës së miratimit të mjetit sipas ADR. Data e miratimit dhe e mbarimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës.	Forma fizike (e gaztë, e lëngët, e ngurtë, pluhur, llum, apo e përzier	Numri i regjistrimit të automjetit (Targa)	Data dhe ora e kryerjes së transfertës	Emri/mbiemri i dorëzuesi/marrësit Adresa Nr. Telefoni E - mail

**URDHËR****Nr. 157, datë 21.4.2015**

**PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË
DREJTAT E ARTISTËVE INTERPRETË
DHE/OSE EKZEKUTUES TË VEPRAVE,
ME TË GJITHA FORMAT E
PËRCJELLJES SË
INTERPRETIM/EKZEKUTIMIT TË
TYRE NË PUBLIK, "AKDIE"**

Duke marrë parasysh propozimin nr. 394, prot. datë 15.4.2015 të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, për licencimin të agjencisë "AKDIE" për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim /ekzekutimit të tyre në publik,

KONSTATOVA SE:

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9380, datë 28.4.2005, "Për të drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar, është kompetencë e ministrit të Kulturës miratimi i dhënies së licencës kësaj agjencie në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim /ekzekutimit të tyre në publik, AKDIE.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të pikës 1 të nenit 108 dhe pikave 1 dhe 3 të nenit 109, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të Drejtat e Artistëve Interpretë dhe/ose Ekzekutues të veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik, AKDIE.

2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro (Furxhi)**

URDHËR**Nr. 158, datë 21.4.2015**

**PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË
DREJTAT E AUTORIT "ALBAUTOR"**

Duke marrë parasysh propozimin nr. 374, datë 31.3.2015 të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, për licencimin e agjencisë së administrimit kolektiv të së drejtës së autorit "ALBAUTOR"

KONSTATOVA SE:

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar, është kompetencë e ministrit të Kulturës dhënia e licencës kësaj agjencie në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 1 të nenit 108, pikës 1 dhe 3 të nenit 109, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të Drejtat e Autorit "ALBAUTOR".

2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro (Furxhi)**

VENDIM**Nr. 7, datë 26.2.2015**

**PËR LICENCIMIN SHA UJËSJELLËS
KANALIZIME MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator



VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit operatorit Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Mirditë me:

Drejtues ligjor: Marie Dodaj;

Drejtues teknik: Vasil Nikolli

2. Operatori sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Mirditë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Rrëshen, komunat: Orosh, Kurbnesh.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare deri më datë 25.2.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 8, datë 16.3.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE
HETIMORE ADMINISTRATIVE**

Në mbështetje të nenit 14 dhe të nenit 27 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe nenit 80 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të nisë procedurën hetimore për marrjen e masave administrative për kundërvajtjen administrative "Ushtrimi i veprimtarisë pa licence", ndaj operatorëve:

a) Shoqëria "Ujësjetllës-Kanalizime Kukës" sh.a.;

b) Shoqëria "Ujësjetllës-Kanalizime Fushë-Arrëz" sh.a.;

c) Shoqëria "Ujësjetllës Has" sh.a.

2. Shoqëritë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi të njoftohen dhe të thirren për t'u dëgjuar mbi objektin e procedimit, sipas grafikut bashkëlidhur.

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi sektori juridik dhe marrëdhënieve me publikun.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 9, datë 16.3.2015

**PËR MOSSHQYRTIM TË
PROPOZIMEVE PËR NDRYSHIM
TARIFE**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe neneve 12, 13 dhe 15 të metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim propozimet për ndryshim tarife për vitin 2015 për shoqëritë:

- "Ujësjetllës-Kanalizime Lezhë" sh.a.;

- "Ujësjetllës-Kanalizime Krujë" sh.a.;

- "Ujësjetllës-Kanalizime Kukës" sh.a.;

- "Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastër" sh.a.;

- "Ujësjetllës-Kanalizime Fier" sh.a.;

2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Tekniko-Ekonomike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 10, datë 16.3.2015

**PËR LICENCIMIN SHA "UJËSJETLLËS
KANALIZIME KAVAJË"**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator



VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit operatorit sh.a Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë me:

Drejtues ligjor: Ndriçim Proj;
Drejtues teknik: Rexhep Vogli;
Drejtues teknik: Sali Vogli.

2. Operatori sh.a. "Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë" autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria B, për përpunimin e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Kavajë, komunat: Golem, Luz i Vogël, Lekaj, Helmas, Synej, Kryevidh.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare deri më datë 15.3.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 11, datë 31.3.2015

**PËR LICENCIMIN SHA "UJËSJIJELLËS
KANALIZIME GJIROKASTËR"**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit operatorit sh.a "Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastrë" me:

Drejtues ligjor: Dashmir Qeli;
Drejtues teknik: Arqile Puleri.

2. Operatori sh.a. "Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastrë" autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Gjirokastrë, komuna Lunxhëri.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare deri më datë 31.3.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 12, datë 31.3.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 11, DATË 21.2.2013 "PËR RINOVIM
LICENCE SHA UJËSJIJELLËS ELBASAN
FSHAT"**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 11, datë 21.2.2013 "Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës Elbasan fshat" bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:
"Drejtues ligjor: Ilir Ropi."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 13, datë 31.3.2015

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM
PUBLIK PËR SHOQËRINË
"U POLIÇAN" SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", si dhe vendimit të KKRR nr. 22 datë 14.11.2014, "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2015", Komisioni Kombëtar Rregullator



VENDOSI:

1. Tarifat për shërbimin e furnizimit me ujë për shoqërinë “U Poliçan” sh.a. për vitin 2015 nuk ndryshojnë.

2. Shoqëria “U Poliçan” sh.a. do të vazhdojë të aplikojë tarifatat e miratuara me vendimin e KKRR-së nr. 27, datë 18.6.2010 " Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik".

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i vlefshëm deri në miratim e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr 14, datë 31.3.2015

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM
PUBLIK PËR SHOQËRINË "UK
ERSEKË" SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", si dhe vendimit të KKRR-së nr. 22, datë 14.11.2014, "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2015", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë “UK Ersekë” sh.a.:

Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	38 lek/m ³	10 lek/ m ³
Institucione buxhetore:	100 lek/ m ³	13 lek/ m ³
Ente private	110 lek/ m ³	18 lek/ m ³

b. Tarifë fikse

	Furnizimi me ujë
Konsumator familjar	100 lek/muaj/klient
Institucione buxhetore:	100 lek/muaj/klient
Ente private	100 lek/muaj/klient

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2015:

- uji pa të ardhura (humbjet): 55 %
- niveli i matjes: 73 %

- kohëzgjatja e furnizimi 21 orë/ditë
- efica e energjisë -
- efikasiteti i stafit 5.5 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 100 %
- mbulimi me kanalizime 100 %
- norma e arkëtimit 94 %
- cilësia e ujit (klor+koliform) sipas standardeve.

3. Pagesa rregullatore vjetore për "UK Ersekë" sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi KKRR nr. 43, datë 7.1.2013 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. “UK Ersekë” shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.4.2015 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

KËRKESË

Nr. 1003/10, datë 20.4.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore arë”, që preken nga ndërtimi i linjës 110 KV, Lapaj-Peshkopi”.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është: OST, sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë komisionit të posaçëm të shpronësimit.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjijnuri

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 KV LAPAJ - PESHKOPI**

Lloji i pasurisë së palujtëshme që shpronësohet: Tokë Arë, Truall, Kullotë

Nr.	Numri I shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. Shpronësim për shtyllë m ²	Vlera e Shpronësi mi në Lek/m ²	Vlera e Shpronësimiit në Lekë për shtyllë
		Emri	Atësia	Mblemri	Nr. Kadastral	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip pronës m ²			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Komuna Qendër Tomin											
Fshati Pollozhan											
1	2	Pretendues			3023	95	arë	14814	88	121	10648
2	3	Pretendues			3023	95	arë	14814	66	121	7986
3	4	Pretendues			3023	95	arë	14814	48	121	5808
4	5	Pretendues			3023	95	arë	14814	17	121	2057
5	6	Flamur		Cela	3023	40/6	arë	5550	17	121	2057
6	8	Kurt		Salkurti	3023	56/10	arë	2640	17	121	2057
		Baudin		Salkurti		56/11	arë	2500			
Fshati Rashnapojë											
7	10	Elmaz		Bojku	3155	35/6	arë	1000	15	121	1815
Fshati Pilafe											
8	11	Ismail		Cenga	2958	125/34	arë	2375	15	121	1815
9	12	Ruzhdi		Muda	2958	117/6	arë	508	15	121	1815
Komuna Kastriot											
Fshati Barovjan											
10	16	Ramadan		Shehu	1252	63/11	arë	4500	17	121	2057
Fshati Brest i Sipërm											
11	23	Dije		Shini	1280	57/5	arë	3770	17	121	2057
12	24	Pretendues			1280	10/38	arë	875	18	121	2178
13	25	Pretendues			1280	2/4	kullotë	3900	15	105	1575
Fshati Sohodoll											

Nr.	Numri I shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. Shpronësim për shtyllë m ²	Vlera e Shpronësimi në Lek/m ²	Vlera e Shpronësimi në Lekë për shtyllë
		Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Kadastral	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip pronës m ²			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Komuna Fushë-Cidhen											
Fshati Renz											
14	27	Riza		Doc	2113	69/2/1	arë	3000	40	121	4840
15	35	Agim		Spata	3169	17/33	arë	1100	17	121	2057
16	36	Pretendues			3169	12/20	arë	10750	18	121	2178
17	38	Pretendues			3169	9/11	arë	1000	15	121	1815
Komuna Silovë											
Fshati Shumbat											
18	42	Pretendues			3442	842	arë	422	15	121	1815
Fshati Sllatinë											
19	46	Pretendues			3475	849	arë	2240	15	121	1815
20	47	Pretendues			3475	869	arë	2625	45	121	5445
21	48	Pretendues			3475	832	arë	17434	35	121	4235
22	49	Hajrulla		Hysa	3475	1129	arë	2550	15	121	1815
23	50	Benjamin		Cekici	3475	811/2	arë	1512	15	121	1815
24	54	Pretendues			3475	112	arë	1840	51	121	6171
Fshati Veleshë											
25	61	Isuf		Hoxha	3799	199	arë	514	15	121	1815
Fshati Kalle											
26	65	Pretendues			2048	344	arë	5108	15	121	1815
27	66	Beqir		Sinani	2048	335/2	arë	1631	17	121	2057
Komuna Kala Dodës											
Fshati Shullan											
28	70	Pretendues			3440	111	arë	1540	45	121	5445
29	71	Pretendues			3440	131	kullotë	18684	35	87	3045
30	72	Pretendues			3440	5	arë	17482	18	121	2178
QARKU KUKËS											



Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. Shpronësim për shtyllë m ²	Vlera e Shpronësimi në Lekë/m ²	Vlera e Shpronësimi në Lekë për shtyllë
		Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Kadastral	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip pronës m ²			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Komuna Bushtricë											
Fshati Palush											
31	81	Isuf	Azem	Poti	2868	480/7	arë	2800	18	114	2052
Fshati Bushtricë											
32	85	Pretendues			1333	807	arë	6200	26	114	2964
33	86	Pretendues			1333	771/5	arë	608	15	114	1710
34	87	Pretendues			1333	556	arë	2800	15	114	1710
35	89	Pretendues			1333	988	kullotë	24852	23	105	2415
36	90	Pretendues			1333	243/3	kullotë	12600	15	105	1575
37	91	Hysen	Osman	Gjici	1333	240/5	arë	595	15	114	1710
		Ismen	Hakik	Gjici	1333	240/8		340			
38	95	Hysni	Brahim	Billa	1333	24/8	arë	1750	23	114	2622
Sipërfaqe totale për shpronësimi në m²									941		
Shuma totale në Lekë për shpronësim									111039		

KËRKESË

Nr. 2425, datë 21.4.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan (shtesa).

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”,

të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur. Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “arë”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasuritë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimi është 4 564 020 (katër milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëzet) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR TIRANË - ELBASAN (SHITESAT)

Nr.	PRONARI	ZK	NR. PAS.	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE	VLERËSIMET			VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emri i pronarit					SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(lekë)		
1	Emin Xhemal Kukli	1977	122/1	arë	2000	350	433	151550	151550	Certifikatë pronësie
2	Gezim Shefqet Sallaku	1498	426/20/1	arë	2430	2035	230	468050	468050	Certifikatë pronësie
3	Kastriot Asqeri Musabelliu	2704	241/5	arë	5685	940	433	407020	407020	Certifikatë pronësie
4	Gezim Hysni Begu	2704	251/20	arë	2100	2100	433	909300	909300	Certifikatë pronësie
5	Beqir Gjuzi	1170	126/139	arë	5390	1600	433	692800	692800	Certifikatë pronësie
6	Bp. Rama	1622	23/48	arë	800	800	230	184000	184000	Certifikatë pronësie
7	Shefki Gjuzi	1170	126/126	arë	3800	1370	406	556220	556220	Certifikatë pronësie
8	Halil Shagrir Rama	2704	477/1	arw	7000	1420	433	614860	614860	Certifikatë pronësie
9	Mustafa Begu	2704	251/21	arw	2200	1340	433	580220	580220	Certifikatë pronësie
TOTALI						11955		4564020	4564020	



NDREQJE GABIMI

Shtojcat e munguara të vendimit nr. 299, datë 8.4.2015 “Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 61, datë 22 prill 2015, faqe 2659.

AKBPM FORMULAR APLIKIMI Nr. 1
SHTOJCA II

AKBPM MA Form Nr. 1

AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE Rruga e Dibrës, Nr. 359/1, Tiranë, Shqipëri	Data e Marrjes:	Nr. Prot:
Aplikim për dhënien e Autorizimit të Tregtimit për një bar	Data e fillimit të aplikimit :	

(Për t'u plotësuar nga AKBPM)

Deklarimi dhe firma

Emri i barit (i shpikur):

Doza(t):

Forma farmaceutike:

Lëndë (t) aktive:

Mbajtësi i Autorizimit
për Tregtim:

Personi i autorizuar për
komunikimin
në emër të aplikantit*:

Konfirmohet se të gjitha të dhënat ekzistuese lidhur me cilësinë, sigurinë dhe efektshmërinë e barit përmbahen në dosjen e barit siç është e kërkuar dhe në mostrat e produktit përfundimtar dhe lëndët aktive të nevojshme për analizë;

* Bashkëngjitur letra e autorizimit për komunikim/firmë në emër të aplikantit dhe marrëveshja me Agjencinë.

** Bashkëngjitur mostrat (në paketimin përfundimtar me etiketimin përfundimtar), në sasi të mjaftueshme për të lejuar një shqyrtim të plotë dhe verifikimin e metodave të kontrollit të përdorura nga prodhuesi (lëndët referuese nq.s. referohen në procedurat e kontrollit).

*** Tarifa duhet të paguhet nga aplikanti jo më vonë se 60 ditë, pasi ka marrë formularin e aplikimit për autorizimin për tregtim dhe faturën nga Agjencia.

**1. Lloji i barit****1.1 Lloji i barit³**

- (i) Lëndë(-ët) aktive kimike ☐ (iii) Barna Bimore ☐ (v) OTC ☐
 (ii) Lëndë (-ët) aktive biologjike ☐ (iv) Të tjera (Specifiko) ☐
 (Shëno kutinë (-të) me X)

2. Të dhënat e aplikimit**2.1 Emri tregtar (i shpikur) i barit****2.2 Emri i lëndës (ve) aktive****2.3 Indikimet terapeutike të propozuara**

Kodi ATC:

(për indikimet kryesore)

2.4 Forma dhe doza farmaceutike**2.5 Rruga(-ët) e administrimit****2.6 Paketimi dhe përmasat e paketimit (bashkëngjitur lista me prezantimet e paketimit ose mostrave)**

(i) Paketimi paresor:	(ii) Paketimi i jashtëm:	(iii) Madhësia (të) e paketimit:
(iv) Periudha e vlefshmërisë së barit:	(v) Periudha e vlefshmërisë së barit (pas hapjes së parë të bliserit):	(vi) Periudha e vlefshmërisë së barit (pas përzierjes ose tretjes):

2.7 Përmbledhja e karakteristikave të produktit farmaceutik (SPC)Anglisht ☐ Gjuhë të tjera (opsionale) ☐ (Specifiko):**2.8 Package Leaflet proposal**Shqip ☐ dhe Anglisht ☐ ose Të tjera ☐ (Specifiko):**2.9 Mbajtësi i Autorizimit për tregtim / personat e kontaktit / kompania**

(i) Aplikanti (Mbajtësi i ardhshëm i Autorizimit për tregtim):

Emri i kompanisë:

Shteti:

2.10 Prodhuesi(-ët)

Emri i kompanisë:

Shteti:

Bashkëngjitur origjinali/ kopje e noterizuar e vlefshme e autorizimit të prodhimit

**3. Dokumentacioni bashkëngjitur**

		Po	Jo/Të Tjera
3.1	Autorizimi nga kompania për personin përgjegjes, i cili duhet të ketë një diplomë në mjekësi, farmaci, stomatologji	☐	☐
3.2	Një deklaratë me shkrim nga mbajtësi i autorizimit të tregtimit i cili nuk është me seli në Republikën e Shqipërisë për emërimin e një përfaqësuesi lokal me seli në Republikën e Shqipërisë dhe informacionin e duhur të kontaktit.	☐	☐
3.3	Çertifikatë e produktit farmaceutik (CPP) specifiko:	☐	☐
3.4	Mostra të produktit farmaceutik përfundimtar + çertifikatë analize	☐	☐
3.5	Përmbledhje e karakteristikave të produktit farmaceutik	☐	☐
3.6	Fletëudhëzuesi, propozimi i paketimit (në Shqip, në Anglisht dhe/ose në gjuhë të tjera)	☐	☐
3.7	GMP (Çertifikata e praktikës së mirë të prodhimit,) e prodhuesit (-esve)	☐	☐
3.8	Çertifikatë/vendim i Autorizimit për tregtim	☐	☐
3.9	Përmbledhje e dosjes në format CTD	☐	☐
3.10	Lista e të gjitha variacioneve që janë aprovuar në Republikën e Shqipërisë në periudhën 5-vjeçare të autorizimit të tregtimit të barit. Kopje të të gjitha aprovimeve të këtyre variacioneve.	☐	☐
3.11	Prezantimi grafik i paketimit të jashtëm dhe atij parësor të barit	☐	☐
3.12	Raporti i Ekspertit mbi cilësinë e produktit	☐	☐
3.13	Raporti i Ekspertit mbi dokumentacionin jo-klinik	☐	☐
3.14	Raporti i Ekspertit mbi dokumentacionin klinik	☐	☐
3.15	Përshkrimi dhe përbërja e barit	☐	☐
3.16	Procesi i prodhimit	☐	☐
3.17	Kontrolli i cilësisë së barit	☐	☐
3.18	Stabiliteti i barit	☐	☐

Numri i CD-e :

Documentacioni për:	I pranuar	I refuzuar
Firma e specialistit të Sektorit të Regjistrimit të AKBPM :		
Firma e Shefit të Sektorit të Regjistrimit të AKBPM :		
Data:		
Data e fundit e Autorizimit për Tregtim:		(për t'u plotësuar pranë AKBPM)

Pagesë prej 350 € për çdo formë/dozë të aplikuar për rinovimin e autorizimit të tregtimit:
Sipas parashikimeve të ligjit Nr. 104/2015 datë 31.07.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”

Tarifa e bankës duhet të paguhet nga aplikanti.

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
Raiffeisen BANK- Tiranë, Shqipëri

Nr. i llogarisë. 0104030780

Konfirmimi i pagesësData. / / 2015

DREJTOR

Emër MBIEMËR



AKBPM MA Form Nr. 2

AKBPM FORMULAR APLIKIMI Nr. 2
SHTOJCA III

AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE Rruga e Dibrës, Nr. 359/1, Tiranë, Shqipëri	Data e Marrjes:	Nr. Prot:
Aplikim për Rinovimin e Autorizimit të Tregtimit për një bar	Data e fillimit të aplikimit :	

(Për t'u plotësuar nga AKBPM)

Deklarimi dhe firma

Emri i barit (i shpikur):

Doza(t):

Forma farmaceutike:

Lëndë (t) aktive:

Mbajtësi i Autorizimit
për Tregtim:

Personi i autorizuar për
komunikimin
në emër të aplikantit*:

Konfirmohet se të gjitha të dhënat ekzistuese lidhur me cilësinë, sigurinë dhe efektshmërinë e barit përmbahen në dosjen e barit siç është e kërkuar dhe në mostrat e produktit përfundimtar;

* Bashkëngjitur letra e autorizimit për komunikim/firmë në emër të aplikantit dhe marrëveshja me Agjencinë.

** Bashkëngjitur mostrat (në paketimin përfundimtar me etiketimin përfundimtar), në sasi të mjaftueshme për të lejuar një shqyrtim të plotë dhe verifikimin e metodave të kontrollit të përdorura nga prodhuesi

*** Tarifa duhet të paguhet nga aplikanti jo më vonë se 60 ditë, pasi ka marrë formularin e aplikimit për rinovimin e autorizimit për tregtim dhe faturën nga Agjencia.



AKBPM FORMULAR APLIKIMI Nr.2

1. Lloji i barit**1.1 Lloji i barit ³**(i) Lëndë(-ët) aktive kimike ☐(iii) Barna Bimore ☐(v) OTC ☐(ii) Lëndë (-ët) aktive biologjike ☐(iv) Të tjera (Specifiko) ☐

(Shëno kutinë (-të) me X)

2. Të dhënat e aplikimit**2.1 Emri tregtar (i shpikur) i barit****2.2 Emri i lëndës (ve) aktive****2.3 Indikimet terapeutike të propozuara**

Kodi ATC:

(për indikimet kryesore)

2.4 Forma dhe doza farmaceutike**2.5 Rruga(-ët) e administrimit****2.6 Paketimi dhe përmasat e paketimit (bashkëngjitur lista me prezantimet e paketimit ose mostrave)**

(i) Paketimi paresor:

(ii) Paketimi i jashtëm:

(iii) Madhësia (të) e paketimit:

(iv) Periudha e vlefshmërisë së barit:

(v) Periudha e vlefshmërisë së barit (pas hapjes së parë të bliserit):

(vi) Periudha e vlefshmërisë së barit (pas përzierjes ose tretjes):

2.7 Përmbledhja e karakteristikave të produktit farmaceutik (SPC)Anglisht ☐Gjuhë të tjera (opsionale) ☐ (Specifiko):**2.8 Package Leaflet proposal**Shqip ☐dhe Anglisht ☐

ose

Të tjera ☐

(Specifiko):

2.9 Mbajtësi i Autorizimit për tregtim / personat e kontaktit / kompania

(i) Aplikanti (Mbajtësi i ardhshëm i Autorizimit për tregtim):

Emri i kompanisë:

Shteti:

2.10 Prodhuksi(-ët)

Emri i kompanisë:

Shteti:

Bashkëngjitur origjinali/ kopje e noterizuar e vlefshme e autorizimit të prodhimit



AKBPM FORMULAR APLIKIMI Nr.2

3. Dokumentacioni bashkëngjitur

		Po	Jo/Të Tjera
3.1	Autorizimi nga kompania për personin përgjegjes, i cili duhet të ketë një diplomë në mjekësi, farmaci, stomatologji	☐	☐
3.2	Një deklaratë me shkrim nga mbajtësi i autorizimit të tregtimit i cili nuk është me seli në Republikën e Shqipërisë për emërimin e një përfaqësuesi lokal me seli në Republikën e Shqipërisë dhe informacionin e duhur të kontaktit.	☐	☐
3.3	Çertifikatë e produktit farmaceutik (CPP) specifiko:	☐	☐
3.4	Mostra të produktit farmaceutik përfundimtar + çertifikatë analize	☐	☐
3.5	Përmbledhje e karakteristikave të produktit farmaceutik	☐	☐
3.6	Fletëudhëzuesi, propozimi i paketimit (në Shqip, në Anglisht dhe/ose në gjuhë të tjera)	☐	☐
3.7	GMP (Çertifikata e praktikës së mirë të prodhimit,) e prodhuesit (-esve)	☐	☐
3.8	Çertifikatë/vendim i Autorizimit për tregtim	☐	☐
3.9	Përmbledhje e dosjes në format CTD	☐	☐
3.10	Lista e të gjitha variacioneve që janë aprovuar në Republikën e Shqipërisë në periudhën 5-vjeçare të autorizimit të tregtimit të barit. Kopje të të gjitha aprovimeve të këtyre variacioneve.	☐	☐
3.11	Prezantimi grafik i paketimit të jashtëm dhe atij parësor të barit	☐	☐
3.12	Raporti i Ekspertit mbi cilësinë e produktit	☐	☐
3.13	Raporti i Ekspertit mbi dokumentacionin jo-klinik	☐	☐
3.14	Raporti i Ekspertit mbi dokumentacionin klinik	☐	☐
3.15	Përshkrimi dhe përbërja e barit	☐	☐
3.16	Procesi i prodhimit	☐	☐
3.17	Kontrolli i cilësisë së barit	☐	☐
3.18	Stabiliteti i barit	☐	☐

Numri i CD-e :

Documentacioni për:	I pranuar	I refuzuar
Firma e specialistit të Sektorit të Regjistrimit të AKBPM :		
Firma e Shefit të Sektorit të Regjistrimit të AKBPM :		
Data:		
Data e fundit e Autorizimit për Tregtim:		
(për t'u plotësuar pranë AKBPM)		

Pagesë prej 350 € për çdo formë/dozë të aplikuar për rinovimin e autorizimit të tregtimit:
Sipas parashikimeve të ligjit Nr. 104/2015 datë 31.07.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”

Tarifa e bankës duhet të paguhet nga aplikanti.

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
Raiffeisen BANK- Tiranë, Shqipëri
Nr. i llogarisë. 0104030780
Konfirmimi i pagesësData. / / 2015

DREJTOR

Emër MBIEMËR



AKBPM MA Form Nr. 3

SHTOJCA IV

AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE Rruga e Dibrës, Nr. 359/1, Tiranë, Shqipëri	Data e dorëzimit të formularit:
Aplikim për Variacion për një bar të Autorizuar për Tregtim	Nr. Prot:

Emri dhe Adresa e Aplikantit/Mbajtësit të Autorizimit për Tregtim të barit:	Emri dhe adresa e personit të autorizuar nga kompania:

Emri i barit	Lënda aktive	Forma farmaceutike	Doza	Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim

Përshkrimi i variacionit, bazuar në Rregulloren e Variacioneve	Tipi i Procedurës (IA; IB ose II)

Qëllimi i variacionit

(Përshkruani shkurt ndryshimet e propozuara. Kur një variacion është rrjedhojë e/ ose e lidhur me një variacion tjetër, një përshkrim i lidhjes ndërmjet këtyre variacioneve.)



Gjendja Aktuale	Gjendja e Propozuar

Dokumentacioni bashkëngjitur
1.
2.
3.
4.

Pagesë prej _____ :

Sipas parashikimeve të ligjit Nr. 104/2015 datë 31.07.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”

Tarifa e bankës duhet të paguhet nga aplikanti.

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

Raiffeisen BANK- Tiranë, Shqipëri

Nr. i llogarisë. 0104030780

Konfirmimi i pagesësData. / / 2015

DREJTOR

Emër MBIEMËR

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 148 lekë